



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Nr. 980/5

Tiranë, më 19.12.2016

V E N D I M

Nr.149, Datë 19.12.2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË AGJENCINË E ZHVILLIMIT BUJQËSOR DHE RURAL, MBI “AUDITMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE, NË AKTIVITETIN EKONOMIK”.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt Vendimin të paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit të dhënë nga Drejtori i Departamentit të Auditimit, si dhe mendimin mbi cilësinë e auditimit të dhënë nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10, 14 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

V E N D O S A

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të “*Auditimit financiar*” të ushtruar në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural.
- II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITUESIT

Opinion i pakualifikuar.

Në gjykimin e KLSH-së, mbështetur në standardet ISSAI 1700¹ dhe ISSAI 1200², pasqyrat financiare vjetore të Institucionit të Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të institucionit më datë 31.12.2015. I njëjti opinion vlen edhe për pasqyrën e realizimit të buxhetit.

Është në përgjegjësinë tonë, si auditues të pavarur, të shprehemi se evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë një bazë të mjaftueshme për dhënien e opinionit të pakualifikuar.

B. MASA ORGANIZATIVE

GJETJA 1

Nga auditimi i funksionimit të sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për vitet 2014-2015 dhe 2016, rezultoi se :

a. Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm në Agjencinë e Zhvillimit Rural dhe Urban, nuk ka mirë funksionuar, pasi ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin nuk është zbatuar nga të gjithë hallkat e njësisë, ndërsa punonjësit nuk kanë njohuri të plota mbi ligjin dhe për pasojë, drejtuesit **nuk kanë mundur të bëjnë** siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion.

b. Për periudhën objekt auditimi, është hartuar dhe miratuar Deklarata e Misionit nga Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Admisnitrimit të Ujërave, por nuk ka një Strategji të plotë të AZHBR, e cila të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë përgjegjës për realizimin e tyre.

c. Grupi i auditimit konstatoi se për vitin 2014 dhe 2015 AZHBR nuk ka depozituar asnjë deklaratë apo raportin vjetor për cilësinë dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm së bashku me pyetësin e vetëvlerësimit në kundërshtim me aktin ligjor të lartpërmendur. Për vitin 2015 me shkresën nr. 73/1 prot. datë 29.01.2016 Drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHRAU është dërguar vetëm pyetësi i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të AZHBR.

d. Nuk janë hartuar **gjurmët e auditimit** të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të emëtuara nga Ministria e Financave. Këto gjurmë të proceseve dhe përgjegjësi, nuk janë identifikuar me emërtimin “Lista e proceseve të punës”, nuk ka miratim dhe arkivim të kësaj gjurme, por në shpjegimet e pyetësit të vlerësimit është cilësuar “Masat për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm do të jenë objekt për periudhën në vazhdim, duke rishikuar strukturën shtimin e stafit etj”.

¹ ISSAI 1700: Objektivi i auditimit është formimi i një opinionit për pasqyrat financiare bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e auditimit dhe shprehja e qartë e opinionit në një raport të shkruar, ku përshkruhet baza e tij.

² ISSAI 1200: Gjatë auditimit financiar, objektiva kryesor të audituesit janë dhënia e një sigurie të arsyeshme, nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale, në mungesë të mashtrimeve apo gabimeve duke përbërë bazën për shprehjen e opinionit nga audituesi si dhe raportimi në përputhje me standardet dhe gjetjet nga auditimi.

- e. Nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe **krijimin e rregjistrit të risqeve**, monitorimin e kontroleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave, pra nuk është hartuar një regjistër i identifikimit dhe kontrollit të risqeve dhe adresimi i personave përgjegjës për çdo risk, i cili duhet të plotësohet, përditësohet në vazhdimësi, si dhe të dërgohet ky regjistër në Kryeministri dhe në Ministrinë e Financave, konform përcaktimeve të kreut III “Identifikimi i risqeve” të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
- f. Në këtë institucion është miratuar Rregullorja e Brendshme, e cila në përgjithësi parashikon raportet punëdhënës-punëmarrës dhe midis vetë punëmarrësve, por institucioni nuk ka hartuar **Kodin e Etikës**, me pretendimin se është rregullorja e brendshme që kryen këtë funksion.
- g. Sipas kërkesave të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS), koordinatori i riskut dhe strategjia e menaxhimit të riskut, për identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve që mund të vënë në rrezik përmbushjen e objektivave të AKSHI-t, **nuk është krijuar në asnjë nga vitet objekt auditimit**, gjë e cila ka sjellë mangësi e shkelje në realizimin e objektivave dhe miradministrimin e fondeve buxhetore dhe asetëve materiale të institucionit.
- h. Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, **nuk kanë rregulla të brendshme** të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

1. Titullari i institucionit, për të rritur përgjegjshmërinë në menaxhimin e riskut, në drejtim të identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut, të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar strategjinë e riskut e cila duhet të përditësohet rregullisht, të paktën 1 herë në 3 vjet, si dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme, duke bërë kështu vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë.
2. Titullari i institucionit të marrë masa për hartimin e deklaratës mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm së bashku me pyetësorin e vetëvlerësimit për aktivitetin e AZHBR, dhe depozitimin e tyre në Ministrinë e Financës në përputhje me nenin 18 i ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar citon se *“Nëpunësi autorizues i çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt aktual”*.
3. Të marrë masat e duhura për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve dhe të hartojë kërkesa specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin të dalë në zbatim të tij. Në mënyrë të veçantë për menaxhimin e riskut pasi, menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe se, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk ka funksionuar si duhet në këtë institucion. Gjithashtu, institucioni të hartojë një procedurë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizën e tyre, si dhe të bëjë dhe vlerësimin e punës së punonjësve.
4. Për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të merren masat për të hartuar gjurmët e auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që

kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve me të rëndësishme.

5. Institucioni të marrë masa në hartimin e Kodit të Etikës, me qëllim vendosjen e rregullave të sjelljes së nëpunësve të administratës publike, sipas standardeve të kërkuara, t'i ndihmoje ata për arritjen e këtyre standardeve dhe të vere në dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë nëpunësi i administratës publike gjithashtu të marrë masa në hartimin dhe miratimin lidhur me delegimin e kompetencave në rregulloren e brendshme duke trajtuar delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.

Menjëherë

GJETJA 2

Nga auditimi i programimit, aprovimit, detajimit dhe monitorimit të buxhetit për vitet periudhe auditimi, u konstatua se:

a. Institucioni, edhe pse në përputhje me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Nëpunësit autorizues ka paraqitur në mënyrë periodike, jo më pak se katër herë në vit, te nëpunësi i parë autorizues, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo projekt të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të projektit buxhetor afatmesëm”, konstatojmë se ka diferenca sa i takon analizës së produkteve. Gjithashtu konstatojmë se, ndryshimet e vazhdueshme nëpërmjet procedurave të sipërpërmendura tregojnë qartë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetimit si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet jo të qëndrueshëm dhe efektiv;

b. Mungojnë metodologjitë e planifikimit sipas qendrave të kostos, të cilat ndihmojnë subjektet publike që jo vetëm të përlllogarisin saktë nevojat për planifikim por edhe të monitorojnë saktë dhe drejtë realizimin e objektivave të njësisë. Vetëm nëpërmjet aplikimit të këtyre metodave, Institucioni (dhe si pasojë palët e interesuara) mund të zbulojnë nëse aktivitetet e njësisë janë në linjë me qëllimet dhe objektivat strategjike të saj.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

1. Strukturat drejtuese të këtij institucioni, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve dhe me strukturat që mbulojnë planifikimin dhe monitorimin e investimeve në Ministrinë e Financave, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përlllogaritjes së kostos së informacionit me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve nga këto objektiva. Procesi i planifikimit të kryhet në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme me qëllim që ndryshimet në shpenzime gjatë vitit të jenë sa më të vogla dhe të kufizohen vetëm në ndryshimet të domosdoshme dhe të pashmangshme.

2. Nevojitet të gjurmohet saktë dhe drejtë konsumimi i burimeve të nevojshme për të shpërndarë shpenzimet (kostot) sipas aktiviteteve që i “shkaktojnë” këto kosto, me qëllim minimizimin deri në eliminimin e rishpërndarjeve mes zërave buxhetore brenda vitit ushtrimor. Institucioni mund të përdorë një sërë metodash, apo praktikat më të mira që sot aplikohen.

Brenda datës 31.01.2017

GJETJA 3

Konstatohet se ndjekja e realizimit të buxhetit dhe raportimi i tij, nuk kryhet nëpërmjet raporteve të monitorimit të buxhetit dhe as evidencave të realizimit të tij, por përfshihet në një pjesë të vogël në raportin tekniko - financiar. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Prej institucionit sqarohet se procesin e monitorimit të buxhetit e kryen MBZHRAU, pasi AZHBR është njësi varësie e saj . Por ndërkohë për të qenë konform asaj çka legjislacioni kërkon dhe për një paraqitje sa më të rregullt të performancës së Agjencisë, duke mbajtur në konsideratë edhe natyrën e veçantë të produkteve që Agjencia ofron sugjerohet që edhe nga ana e vet institucionit të kryhet monitorimi i buxhetit si në nivel artikulli dhe kapitulli ashtu edhe në bazë të produkteve. Procesi kualitativ i monitorimit dhe vlerësimit ofron pasqyrë të qartë rreth arritjes së rezultateve dhe objektivave të synuara. Identifikon problematikat dhe ndihmon marrjen e veprimeve të duhura përmirësuese. Monitorimi i drejtë siguron informata kualitative mbi gjendjen e projekteve të realizuara. Informacionet që institucioni zotëron mbi ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, së bashku me shpjegimet përkatëse, shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë, argumentet që lidhen me mosrealizimin e produkteve duke paraqitur masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre, si edhe analiza e kostos së produkteve duke paraqitur shpjegimet përkatëse në rastin e kostove shtesë të realizuara sipas ligjit duhet ti bashkëngjiten raportit të monitorimit të buxhetit. Çdo shpenzim buxhetor është kryer mbi bazën e urdhër-shpenzimeve të plotësuara me të gjitha të dhënat e kërkuara dhe firmosur rregullisht. Si aktivitet kontrollues dhe monitorues shërben jo vetëm raportimi në institucionin qendror në lidhje me realizimin e shpenzimeve po edhe rakordimi me Degën e Thesarit.

NIVELI I PRIORITETIT

I Mesëm

REKOMANDOJMË

AZHBR në Raportet e monitorimit duhet të përfshijë informacion mbi arritjet në terma sasiore dhe në vlerë të produkteve të realizuara; të identifikojnë mos arritjet e objektivave dhe të shpjegojnë shkaqet e tyre duke propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës. Vlerësohet me rëndësi të veçantë dhe rekomandohet të kryhet matja dhe raportimi i progresit në drejtim të ekzekutimit të buxhetit, duke ulur riskun për “shpërdorime” apo keqmenaxhim të tij, duke rishikuar gjendjen e vlerësuar, situatën ku agjencia ndodhet dhe rrjedhimisht duke shmangur konfondimet rreth përdorimit të papërshtatshëm të ndarjes buxhetore.

Menjëherë

GJETJA 4

Për periudhën e audituar **i konstatua se mungonte unifikimi në mënyrën e mbajtjes së llogarive kontabile** gjatë të tre periudhave. Përpos përdorimit të programit Financa 5 i cili shërben për kontabilizimin e të dhënave financiare sërish në AZHBR, vazhdohet në mbajtjen e llogarive sipas ditarit në Excel sidomos për llogarinë 606.

Nga auditimi i zonave të llogarisë, është e rëndësishme të theksojmë rëndësinë e paraqitjes së pasqyrave financiare vetëm në nivel të konsoliduar, dhe jo një bashkim mekanik siç ndodh me llogarinë 606 e cila zë gati 80 % të buxhetit total të AZHBR-s, duke nënkuptuar aplikimin e të njëjtës metodologji kontabël për evidentimin dhe vlerësimin e zërave të tyre.

Kjo mënyrë mbajtje e llogarive rrit riskun e manipulimit të dhënave, të mundësisë së gabimit

njerëzor në evidentimin e transaksioneve dhe po ashtu në minimizimin e sigurinë e arsyeshme rreth vlerave kontabël, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë. Si pasojë, mungesa e kryerjes së një procesi të tillë në mënyrë të unifikuar, cënon nivelin e sigurisë së arsyeshme të audituesve të pavarur, për të njohur dhe pranuar “vlerat” e aktiveve.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

AZHBR të marrë masa të menjëherëshme që të gjithë sektorët të aplikojnë të njëjtën mënyrë për mbajtjen dhe kontabilizimin e të dhënave financiare. Të kryhet një unifikim i mënyrës së regjistrimit të transaksioneve financiare në mënyrë që të minimizohen risqet e mundshme. Aplikimi i të njëjtës metodologji kontabël për evidentimin dhe vlerësimin e zërave do të rrisë nivelin e sigurisë mbi të dhënat e raportuara.

Menjëherë

GJETJA 5

Nga auditimi konstatohet se AZHBR-ja trashëgon në mënyrë të qëndrueshme debitorë dhe kreditorë, të cilët në total deri më 30.9.2016, janë në vlerën 2,088,803,343 lekë, një nivel i lartë ky, i debitorëve të mbartur nga ish projekti 2KR, ku pavarësisht përpjekjeve të dokumentuara nga ana e AZHBR, të shoqëruara edhe me kosto të larta të shpenzimeve gjyqësore, nuk kanë sjellë një zgjidhje të situatës.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

MBZHRAU si institucion qëndror në bashkëpunim me AZHBR dhe MF, pas analizimit të situatës mbi debitorët, të vlerësojnë të gjitha mundësitë për arkëtimin qoftë edhe pjesor të detyrimeve dhe të përshtaten skema alternative shlyerje që fermerët të jenë të gatshëm për derdhjen e shumave për të cilat janë debitorë.

Nisur nga fakti që skema shoqërohet me nivel të lartë debitorësh duhet të shtohet vëmendja tek mënyra e funksionimit të skemës dhe veçanërisht në sanksionimin e të drejtave dhe detyrimeve e palëve. Të ketë sanksione të ekzekutueshme menjëherë për rastin e deviacioneve nga objektivat e skemës dhe në të gjitha rastet të vlerësohen drejt instrumentet që do të mundësonin mbrojtjen e interesave të shtetit. Për të gjitha rastet e shtesës së debitorëve të analizohen edhe përgjegjësitë institucionale që kanë krijuar kushtet për rritjen e debitorëve.

Menjëherë dhe në vazhdim

GJETJA 6

Nga auditimi i përgatitjes së pasqyrave financiare për të dy vitet vihen re *gabime në mbartjen e shifrave*, të cilat mund të kenë ardhur si pasojë e mbingarkesës së personit që ka realizuar mbartjen e të tyre, po ashtu edhe mos rakordime në shifra të vogla si pasojë e rrumbullakimeve të kryera, të cilat janë të përdorura së tepërmi. Këto gabime duke qenë se shpeshia e tyre është e lartë sjellin deformim të pamjes së pasqyrave financiare.

NIVELI I PRIORITETIT

I Mesëm

REKOMANDOJMË

Mbështetur edhe në kërkesat e Ligjit nr.9228, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, sipas të cilit pasqyrat financiare duhet të përgatiten duke treguar shkallën e rrumbullakimit të shifrave në mënyrë të tillë që grupi i auditimit të ketë siguri në dhënien e opinionit, rekomandohet të ushtrohet më tepër kujdes gjatë mbartjes së shifrave si dhe të tregohet shkalla e rrumbullakimit.

Në vazhdimësi

GJETJA 7

Në lidhje me përgatitjen e *shënimeve shpjeguese* të pasqyrave financiare për të dy vitet, 2014/2015 ka *një nivel të lartë formaliteti* në ndërtimin e tyre.

U vunë re pyetje pa përgjigje në format apo me përgjigje tepër të shkurtra që nuk të shpjegojnë hollësisht situatën. Shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare janë element i rëndësishëm (jo vetëm sipas kërkesave të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.14, datë 26.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve *me donatore te huaj*”, por edhe sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit SNKP 1, paragrafi 128), të cilat duhet ndër të tjera, të sigurojnë edhe atë informacion shtesë, i cili nuk mund të paraqitet në të gjitha formatet e pasqyrave financiare. Çdo zë i shprehur në këto pasqyra duhet të lidhet me referencën përkatëse tek shënimet shpjeguese.

NIVELI I PRIORITETIT

I Mesëm

REKOMANDOJMË

Të ushtrohet më tepër kujdes gjatë ndërtimit të formatit të shënimeve shpjeguese nga ana e personit i cili bën plotësimin e pasqyrave financiare të institucionit, në mënyrë që të merret i plotë informacioni që pasqyron gjendjen e tij.

Në vazhdimësi

GJETJA 8

Nga auditimi i kryer mbi periudhën e audituar vitet 2014, 2015 dhe 9 mujori 2016 rezultoi se në relacionin shoqërues të Pasqyrave Financiare shpjegimi analitik për llogarinë e **Granteve Korente** është më shumë se i vakët, nëpërmjet tij lexuesi i pasqyrave nuk arrin të marr asnjë feedback mbi origjinën, kohën se kur janë marr apo nëse janë marr kundrejt kushtit apo jo. Po ashtu u konstatua se edhe në shënimet shpjeguese mungon informacioni rreth këtyre investimeve dhe burimit të financimit për to.

Ndërkohë që vet kuadri ligjor, ta kërkon specifikisht një informacion të tillë *Udhëzimi nr. 17, datë 25.09.2012 “Për qarkullimin pa pagesë të aktiveve brenda njësave shpenzuese”*. Theksohet se në çdo rast dhe në vijim, informacione të tilla duhet të reflektohen edhe në relacionin shpjegues që shoqëron pasqyrat financiare.

NIVELI I PRIORITETIT

I Mesëm

REKOMANDOJMË

Institucioni të marrë masa që të pasqyrojë informacionin si në relacionin shoqërues ashtu edhe në shënimet shpjeguese rreth granteve dhe zërave të tjerë sensitive për buxhetin. Në këtë mënyrë lexuesi i pasqyrave financiare arrin të kuptojë gjendjen e institucionit, njësia zbaton kuadrin ligjor dhe rregullator dhe pasqyron një situatë financiare të shëndoshë të saj. Informacioni shërben si bazë për planifikim dhe vendim-marrjen dhe rritet kuptueshmëria dhe transparenca e të dhënave.

Brenda 31.01.2017 dhe në vazhdim

GJETJA 9

Në bilancet e agjencisë, për të dy vitet 2014, 2015 konstatohet se

a) **Në lidhje me Caktimet të përfshira në Inventarin Ekonomik:** vazhdon mbartja në zërin “Aktive Qendrore të Trupëzuara” e llogarisë kontabël 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje” e vlerës 4,215,407 lekë, qysh prej bilancit të vitit 2013 e cila është mbartur deri në kalim zyrtar të këtij zëri në llogari të godinës së MBZHRAU. Në mbështetje të Urdhrit të Ministrisë të Bujqësisë Nr 12 datë 20.01.2014 me Nr 6265/1 Prot. për transferimin e zyrave të AZHBR nga ambientet e MBZHRAU tek godina e përdorura si zyra të AKU-s me ane të shkresës Nr. 1156 Prot. Date 6.5.2014, AZHBR i ka rikërkuar MBZHRAU kalimin kapital të shumës 4,215,407 lekë. Ndërkohë nuk është arritur në zgjidhjen e problemit me Ministrinë dhe kjo shumë vazhdon të mbartet në bilancin e AZHBR-së.

Si pasojë e kësaj mbartje paraqitja e informacionit financiar nuk jep gjendjen reale të njësisë duke mbajtur parasysh se në të janë edhe vlera që nuk i përkasin agjencisë. Kjo shkakton një paraqitje jo të drejtë të llogarisë së aktiveve dhe në këto kushte cënon parimet bazë të ndërtimit të pasqyrave financiare si: Mbështetur në SKK 15, shkelet parimi i Besueshmërisë: Për të qenë i dobishëm, informacioni duhet të jetë i besueshëm. Informacioni mbart cilësinë e besueshmërisë, kur ai është i paanshëm dhe nuk mbart gabime materiale, si dhe kur përdoruesit mbështeten mbi të, duke pasur besim që ky informacion është një prezantim besnik i asaj që ky informacion përpiqet ose pritet në mënyrë të arsyeshme të prezantojë.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

AZHBR në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të mari masa të menjëhershme, për të realizuar ndarjen nga Bilanci Kontabël i AZHBR-së ,të inventarit ekonomik të zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në MBZHRAU dhe të procedohet me trajtimin e tij, pasi mbartja e shumave që nuk i përkasin aktivitetit të institucionit bën që pasqyrat financiare të tij të mos pasqyrojnë situatën reale.

Menjëherë

GJETJA 10

*Në lidhje me mënyrën e llogaritjes së **amortizimit** konstatohet se problematika e institucionit qëndron në faktin se ai vazhdon të trashëgojë si aktivitetin financiar edhe inventarin e projektit 2KR, si pjesë të inventarit të tij. *Inventarët Ekonomik të Projektit 2KR, qysh prej fillimit janë bërë hyrje me vlerë joreale, sepse nuk dihet vlera fillestare e tyre.* Për 2014 është menduar si zgjidhje prej institucionit llogaritja e amortizimit të akumuluar duke detajuar secilin zë të inventarit si peshë specifike mbi inventarin total të AZHBR-së, dhe mbi këtë peshë specifike kanë aplikuar normat e lejuara të amortizimit si përqindje mes diferencës së gjendjes së inventarit në fund të periudhës me peshën specifike në totalin e inventarit. Kjo mënyrë mbarte parregullsi në vetvete dhe shifra e paraqitur nuk pasqyronte realitetin.*

Për vitin 2015 është proceduar ndryshe nga viti 2014, pas një marrëveshje verbale me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrinë e Financave është vendosur të merret prej Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor Rajonal një vit bazë si origjinë për procedimin e llogaritjes së amortizimit. Në këtë kuadër nga ana e agjencisë është marr viti 2012 si origjinë për makinat, dhe është kryer një ndarje e asetëve me qëllim të realizimit sa më efikas të veprimtarisë financiare. Por konstatohet se ky veprim është kryer vetëm për makinat ndërsa për pjesën tjetër të aktiveve jo. Sa më sipër ritheksojmë se agjencia ka kryer veprimet e llogaritjes së amortizimit mbi një marrëveshje verbale, pa pasur një bazë ligjore ku mbështeten. Përcaktimi i origjinës i bërë vetëm për makinat, është bërë apriori nuk ka fakte të dokumentuara që ta mbështesin veprimin, ndaj përsëri mënyra e llogaritjes së amortizimit nuk është korrekte.

NIVELI I PRIORITETIT

I Mesëm

REKOMANDOJMË

Duke qenë se llogaritja e amortizimit në pasuritë shtetit nuk ka efekte financiare por vetëm trajtë teorike, me qëllim arritjen e rezultateve sa më të sakta mbështetur në SKK 5, rekomandojmë të rishikohet mënyra e llogaritjes për ti dhënë një zgjidhje përfundimtare këtij problemi. Të kryhen të gjitha sistemimet e nevojshme kontabël që lidhen me veprimin.

Në vazhdim

GJETJA 11

Nisur nga shkresat që na u vendosën në dispozicion prej institucionit gjatë periudhës së auditimit, konstatuam se, zëri “Studime dhe kërkime” (llog. 202) me vlerën e **21,674,642 lekë**, i cili daton nga viti 2009 dhe mbartet në Pasqyrat Financiare të agjencisë qysh prej vitit 2013, edhe pas kërkesave të herë pas herëshme nga ana e grupit të auditimit, fizikisht punimin e studimit agjencia deri në momentin e mbajtjes së këtij projekt raporti (datë 25.11.2016) , **nuk na e vendosi në dispozicion.**

Pra pavarësisht mbajtjes në kontabilitet, njësia nuk e disponon fizikisht studimin që të justifikoj vlerën e pasqyruar në Aktivin e Bilancit të AZHBR-s.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDIJMË

Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa të menjëhershme për gjetjen e projektimit i cili duhet të justifikojë vlerën e mbartur në kontabilitet, në të kundërt të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe personat përgjegjës të zhdëmtojnë shumën prej **21,674,642 lekë**.

Menjëherë

GJETJA 12

Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se njësia për vitin 2015 kishte parashikuar në zërin “blerje pajisje e makineri” një buxhet prej 7,000,000 lekë, gjatë vitit pas marrjes së një financimi nga GIZ për të njëjtën vlerë ajo kërkoj ndryshim të destinacionit të përdorimit të fondeve nga blerje pajisje në blerje makine, me shkresë nr. 181 prot. datë 22.01.2015. Pas marrjes së aprovimit prej Ministrisë së Financave, shkresa nr 2656/1 datë 26.02.2015, fondin njësia e përdori për blerjen e dy makinave. Ajo çka konstatohet është se në Bilancin Kontabël pasqyrohet tek llogaria 215 “Mjete transporti”, ndërkohë që duhej të ishte pjesë e llogarisë 602.

NIVELI I PRIORITETIT

I Mesëm

REKOMANDIJMË

Me qëllim reflektimin e një situatë reale financiare të njësisë dhe rritjen e transparencës së të dhënave, AZHBR të jetë e kujdesshme për të shmangur gabimet e mësipërme gjatë rakordimeve me Thesarin si dhe gjatë mbartjes së tyre në pasqyrat financiare.

Menjëherë

GJETJA 13

Nga auditimi të pagave, shpërblimeve të tjera personeli dhe Sigurimeve Shoqërore për vitet 2014-2015 dhe 9 mujorin e 2016, rezultoi:

a. Nga kontrolli me zgjedhje i dosjeve të punonjësve grupi i auditimit konstatoi se ka mungesë dokumentacioni në disa prej dosjeve të personelit. Në të gjitha dosjet e personelit ekziston fleta e inventarit por në asnjë rast nuk është e firmosur nga Nënpunësi dhe nga Drejtori i Personelit në kundërshtim me formatin në lidhjen 1 të Vendimin Nr. 117, datë 5.3.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

b. Nga auditimi i dosjeve të personelit të auditit të brendshëm, sipas strukturës së miratuar përbëhet nga një përgjegjës sektori dhe tre auditues ku rezultoi se vetëm përgjegjësi i sektorit është i certifikuar si “Auditues i Brendshëm” ndërsa tre sepcialistet jo, në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr.114/2015 “Për Audituesin e Brendshëm në sektorin Publik”.

c. Në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, jo në të gjitha dosjet e personelit bashkalidhur ndodhet vlerësimi për të treja vitet si periudhë auditimi. Grupi i auditimit konstatoi se të gjitha vlerësimet për të tre vitet e periudhës së objekt auditimit janë të pa protokolluara dhe pa datë të plotësuar në formularët standard, pra nuk kanë ekstremitetet e një dokumenti zyrtar.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

1. Mbështetur në VKM nr.117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurat dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrimit qendror të personelit”, Departamenti i Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e të gjitha mangësive të konstatuara gjatë këtij auditimi në dosjet e personelit. Dokumentave të cilat nuk janë njësuar me origjinalin t’ju bëhet njësimi i tyre.
2. Institucion të marrë masa për sigurinë e kualifikimit të punonjësve konform kritereve përkatëse, përpara së të plotësojë strukturën e miratuar. Audituesit e ZHBR të marrin masa në certifikimin nga Ministria e Financës si “Auditues të Brendshëm” sipas nenit 11 të ligjit nr.114/2016 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” i cili thekson kriteret që duhet të përmbushë një punonjës i cili punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm.
3. Për vitin 2014, 2015 dhe 9-mujroin e 2016, Departamenti i Burimeve Njerëzore të procedojë me arkivimin e dosjeve për vlerësimet e punonjësve në zbatim të dispozitave të ligjit për arkivat dhe normave tekniko-profesionale.

Menjëherë

GJETJA 14

Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2015 janë kryer pagesa në vlerën 4,639,808 lekë për shpenzime gjyqësore dhe të gjitha ekzekutimet e vendimeve gjyqësore janë kryer me përmbarues privat, duke e kaluar afatin për likuidimin vullnetar. Një veprim i tillë, shton koston e buxhetit të AZHBR dhe njëkohësisht rëndon në buxhetin e shtetit.

Për vitin 2016, AZHBR duhet të likujdojë edhe 8 vendime gjyqësore të tjera. U konstatua se nuk është bërë asnjë parashikim për shpenzimet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në situacionin e shpenzimeve buxhetore për periudhën 1 janar deri në 31 gusht 2016. Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural duhet të marrë masa në parashikimin e këtij zëri.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

Detyrimet financiare për pagat e punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna sipas vendimeve të formës së prerë të gjykatës, të rregjistrohen në kontabilitetin përkatës të AZHBR. AZHBR, me paraqitjen e vendimeve të formës së prerë të gjykatës, të marrë masat e nevojshme duke vendosur detyrat konkrete për çdo hallkë të institucionit, për zbatimin vullnetar të vendimeve të formës së prerë të gjykatës. Në të kundërt, personat përgjegjës të zhduqojnë vlerën e shpenzimeve përmbarimore

Në vazhdimësi

GJETJA 15

Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, për vitin 2014 - 2015, u konstatua se:

a. Institucioni, për vitin 2014 dhe 2015 nga auditimi i procedurës së mbajtjes dhe kontabilizimit të aktiveve rezultoi se çdo aktiv ishte i regjistruar dhe i kontabilizuar sipas dispozitave ligjore por njësisia nuk dispononte një **regjistër kontabël i aktiveve** që zotëron apo që ka në administrim, situatë kjo në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 28, “Regjistri i aktiveve

të njësisë, duhet të përfshijë si aktivet afatgjatë ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital”.

AZHBR nuk ka një **regjistër analitik aktivesh sipas formatit** ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike, sipas pikës 30 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, por posedon një regjistër në formë të sintetizuar.

b. Komisioni i inventarizimit nuk kishte të përpiluar **një raport** lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësim paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet, lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues”.

NIVELI I PRIORITETIT

I Mesëm

REKOMANDOJMË

1. Nëpunësi Autorizues i njësisë brenda strukturës së institucionit, të caktojë nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të aktiveve. Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjatë ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë.

2. AZHBR duhet të ndërtojë një **regjistër analitik aktivesh sipas formatit** ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

Brenda datës 31.01.2017

GJETJA 16

Nga auditimi i gjendjes në magazina rezultoi se ka mallra e materiale të hyra në magazinën e AZHBR-s dhe në ambientet e saj, të bëra dhuratë (10 cope TV Plazma LG), për të cilat nuk kishte asnjë lloj dokumentacioni origjine, por thjesht janë të regjistruar në librin e magazinës si artikuj dhuratë dhe cilët persona i kanë në përdorim, pa vlera dhe pa u shtuar si vlerë në inventarin ekonomik.

NIVELI I PRIORITETIT

I Mesëm

REKOMANDOJMË

Institucioni të marrë masa në zbatim të udhëzimit nr 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të bëhet vlerësimi dhe kontabilizimi i artikujve të marrë dhuratë, si dhe pasqyrimin në kartelat personale të personave që i kanë në përdorim duke i shtuar si vlerë në inventarin ekonomik.

Brenda datës 31.01.2017 dhe në vijimësi

GJETJA 17

Nga auditimi me zgjedhje i pagesave për shërbimet e udhëtimit e dietave brenda vendit për vitin 2014 dhe 2015 dhe 6 mujorin e vitit 2016, në zbatim të VKM nr. 228, datë 15.04.2001 “Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre”, i ndryshuar, rezultoi se, llogaritja e dietave është bërë sipas dokumenteve të firmosura nga personat përkatës, duke nxjerrë urdhrin e shërbimit ku është përcaktuar qëllimi dhe afati i tij. Nga auditimi konstatohet se i gjithë dokumentacioni vërtetues i shpenzimit për dieta: viti 2014, në vlerën 6,004,018 lekë; viti 2015- në vlerën 3,986,280 lekë dhe 9-mujori 2016 në vlerën 3,057,540 lekë nuk ndodhet lidhur me urdhër shpenzimet e kaluara në thesar. I gjithë ky dokumentacion nga sektori i financës mbahej në një dosje të vecantë, jashtë lidhjeve të bankës, të pa vulosura dhe miratuara nga thesari.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

Nëpunësi Autorizues i njësisë brenda strukturës së institucionit, dhe nëpunësin zbatues të marri masa të menjëhershme për plotësimin e çdo urdhër shpenzimi bashkëngjitur të cilit të jenë dokumentat vërtetues të shpenzimit të kryer, (kjo për vitet 2014-2015). Të ndërpritet menjëherë praktika e mbajtjes së dokumentave vërtetues në dosje të veçanta (për vitin 2016).

Menjëherë

GJETJA 18

a. Nga auditimi i shpenzimeve të karburantit dhe normativave u konstatua se: për automjetet, normativat e miratuara të konsumit të karburanti në litra/100 km, i përkasin vitet 2012. Normativat janë miratuar me komision të ngritur me urdhër të titullarit të AZHBR-së datë 28 dhe 30 Mars 2012 dhe janë 15 litra/100 km për 3 automjetet tip Land Rover dhe 16 litra/100 km për 1 automjet tip Toyota. Dy automjetet e tjerë janë blerë gjatë vitit 2015.

b. Nga auditimi konstatohet se shpenzimet janë të larta për tre vitet: viti 2014 në vlerën 2,659,494 lekë, viti 2015 në vlerën 3,698,331 lekë, dhe 9 mujori 2016 në vlerën 813,100 lekë. Konstatuam se ka automjete të cilat përshkojnë brenda një dite shumë kilometra, duke përshkruar deri në 28 fshatra, të cilat me rezervë shprehemi se nga pikëpamja fizike njerëzore si dhe orëve të punës është tejet e pamundur, ndërkohë që misioni i shërbimit është takimi me banorët e zonave rurale për shpjegimin e skemave të bujqësisë.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

Me qëllim që të kemi një planifikim më real dhe në balancë midis lëvizjeve kilometrike dhe realizimit të misionit për të cilin kryhen lëvizjet, hartimi i programeve të punës dhe monitorimi i tyre të marri një vëmendje më të madhe nga Drejtoria e Shërbimeve në AZHBR. Nëpunësi Autorizues i njësisë, me urdhër të veçantë të ngrëjë një komision për rishikimin e normativave të konsumit të karburantit, pasi ato i përkasin vitit 2012.

Brenda datës 31.01.2017

GJETJA 19

Nga auditimi konstatohet një numër relativisht i lartë i blerjeve kryesisht me shërbim mirëmbajtjeje (sidomos viti 2015), që krijon përshtypjen e copëzimit të fondeve, ndërkohë që prokurimi i shërbimeve është fituar nga operatorë me vlerë më të vogël çfarë tregon për ekzistencën e risqeve potenciale mbi planifikimin jo të kujdesshëm të nevojave, të cilat çënojnë efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

Me qëllim menaxhimin efektiv të fondeve, si dhe rritjen e efektivitetit të kontrolleve mbi këto fonde, merr rëndësi fokusimi drejt planifikimit të kujdesshëm të nevojave nga ana e institucionit, minimizimi i blerjeve të vogla.

Menjëherë

TË TJERA.

Ti kërkohet, Ministrisë së Financave të marr në shqyrtim dhe të shprehet lidhur me dy interpretime të ndryshme, të VKM nr. 929 datë 17.11.2010 ,Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, konkretisht në pika 2.4 “ Të ardhura të përjashtuara”, mbi tatimin e fondit të veçantë, ku në sektorin publik dhënia e shpërblimeve për pension konsiderohet ndihmë dhe nuk tatohet, ndërkohë që në sektorin privat konsiderohet si shpërblim dhe tatohet, pasi, nga auditimi në AZHBR, u konstatua përdorimi i fondit të veçantë për shpërblim në masën e një page mujore, për daljen në pension pleqërie i cili i është nënshtruar mbajtjes së tatimit në burim, ndërkohë që për raste të tjera nuk i është nënshtruar mbajtjes së tatimit në burim.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R